



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr. 03/L-040, nenin 16 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, si dhe në pajtim me Ligjin nr. 04/l-022 për përdorim civil të eksplozivëve, nxjerr:

U R D H Ë R E S Ë PËR NDALIMIN E PËRDORIMIT TË MJETEVE PIROTEKNIKE

I

NDALOHET përdorimi i mjeteve piroteknike/eksplozivëve në sheshe, rrugë, tregje dhe hapësira tjera publike në territorin e Komunës së Podujevës.

II

Ndalesa sipas pikës I të kësaj urdhërese vlen për periudhën 22 dhjetor 2022 deri më 03 janar 2023.

III

Personat të cilët veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj urdhërese do të gjobiten në përputhje me rregullativën ligjore në fuqi.

IV

Për zbatimin e kësaj urdhërese kujdeset Drejtoria e Inspektionit.

V

Urdhëresa hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Drejtorisë së Inspektionit
Zyrës për Marrëdhënie me Publikun
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-016/01-0103501/22
Podujevë, datë: 21.12.2022

